

URDHËR
Nr. 678, datë 29.6.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 141, DATË 26.3.2020, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT DHE ORGANIZIMIT TË KOMISIONIT TË
REGJISTRIMIT TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 6, të nenit 9, të ligjit nr. 17/2020, “Për produktet plehëruese”,

URDHËROJ:

1. Në rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 141, datë 26.3.2020, “Për miratimin e rregullores dhe funksionimit, dhe organizmit të Komisionit të Regjistrimit të Produkteve Plehëruese”, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

- a) Në pikën 5, të nenit 5, pas fjalës “lirohet” shtohet teksti “/zëvendësohet”;
 - b) Në pikën 5, të nenit 5 pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje: “ç) me kërkesë të institucionit që e ka propozuar/caktuar;”;
 - c) Pika 2 e nenit 6 shfuqizohet.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla